

Vendim nr. 241 datë 25.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 25.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 39 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **AHMET JANGULLI**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve penale për disponimin ndëshkues ndaj avokatit, nr. 29, datë 12.03.2022 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Dibër; nr. 688 (30-2023-2187), datë 17.05.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-717, datë 24.04.2025 të Kolegjit Penat të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si rrjedhojë e cenimit të procesit të rregullt ligjor (ndaj standardit të arsytimit të vendimit, mosarsyetim ndaj mohimit/cenimit/mosnjohjes të së drejtës), në të drejtën e aksesit në gjykatë. Shpenzimet gjyqësore (kërkesë, mbrojtje dhe gjykim) t'i ngarkohen Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe/ose subjektit të interesuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 17, 42, 116 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28, 49, 50, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së

**Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000);
Praktikat më të mira të Gjykatës Kushtetuese.**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, në cilësinë e avokatit të shtetases M.J., më 11.03.2022, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër një kërkesë penale për përjashtimin e një gjyqtari nga një proces penal, në të cilin e mbrojtura nga kërkuesi, me profesion “notere”, është me cilësinë e të pandehurës për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 3, i Kodit Penal (KP), të kryer në bashkëpunim. Kjo kërkesë është paraqitur për shkak të fjalorit që pretendohet se është përdorur nga gjyqtari i çështjes dhe për shkak të vendimit të ndërmjetëm për marrjen e nënshkrimeve për përmbushjen e detyrës nga eksperti kriminalist për kryerjen e ekspertimit grafik.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 29, datë 12.03.2022, ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe dënimin me gjobë të kërkuesit në shumën 50.000 lekë për abuzim me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit. Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkesa është paraqitur nga një person që nuk i përket e drejta dhe është një kërkesë e përsëritur. Në këtë kontekst, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesi ka abuzuar me të drejtën për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit duke zvarritur gjykimin.

3. Në datën 18.03.2022 kërkuesi i gjobitur ka paraqitur kërkesën me objekt rivlerësimin e disponimit ndëshkues përkundrejt tij, në cilësinë e përfaqësuesit të shtetases M.J., në vendimin penal nr. 29, datë 12.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, pranimin e ankimit dhe revokimin e vendimit të ndërmjetëm, përkundrejt pjesës ndëshkuese, si dhe heqjen e gjobës në shumën 50,000 lekë dhe shpenzimeve gjyqësore në ngarkim të kërkuesit. Kjo kërkesë i ka kaluar për gjykim të njëjtit gjyqtar që ka vendosur për kërkesën për përjashtim dhe dënimin me gjobë të kërkuesit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 31, datë 29.03.2022, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore të saj për kërkesën penale nr. 31 akti, datë 18.03.2022 të kërkuesit dhe objekt rivlerësim disponimi ndëshkues, si dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, asaj të gjykatës së apelit. Ajo gjykatë ka arsyetuar se pavarësisht emërimit të ankimit “rivlerësim disponimi ndëshkues”, nga përmbajtja e aktit procedural

rezultoi se bëhej fjalë për ankimin ndaj vendimit për mospranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes dhe saktësisht pikës 3, ku ishte vendosur dënimi me gjobë në shumën 50,000 lekë i avokatit për abuzim me të drejtën procedurale të përjashtimit të gjyqtarit, ndërkohë që në dispozitiv thuhej qartazi se kundër vendimit ushtrohej ankim bashkë me vendimin përfundimtar. Pavarësisht këtij fakti avokati ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 688 (30-2023-2187), datë 17.05.2023, ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. 29, datë 12.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Ajo gjykatë ka arsyetuar se ankimi është paraqitur nga kërkuesi ndaj një vendimi të paankimueshëm ndaj duhej të vendosej mospranimi i marrjes në shqyrtim të tij. Neni 407 i Kodit të Procedurës Penale (KPP), në mënyrë taksative përcakton se ankimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara nga ligji, i cili cakton se cilat vendime mund të ankimohen, mjetet e ankimit, llojet e ankimeve, si dhe subjektet e legjitimuara për të ushtruar ankim.

6. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-717, datë 24.04.2025, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në rekurs nuk janë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Ajo gjykatë ka vlerësuar se nuk ishte parashtruar asnjë shkak që cenonte vendimmarrjen e gjykatës së apelit. Sipas saj, me të drejtë gjykata e apelit ka arsyetuar se neni 22/a i KPP-së është plotësuar i nenit 22 të KPP-së, i cili parashikon të drejtën e ankimit bashkë me vendimin përfundimtar. Ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, ndaj vendimit të dënimit me gjobë sipas nenit 22/a të KPP-së nuk mund të paraqitet ankim i veçantë, por mund të animohet vetëm me vendim përfundimtar.

7. Në datën 14.07.2025 (*sipas shërbimit postar*), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.07.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial*, pasi vendimet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatës së Lartë nuk u kanë dhënë përgjigje për pretendimet e tij, duke shkelur parimin e subsidiaritetit. Cenimi i kësaj të drejte i ka mohuar kërkuesit edhe disa të drejta të tjera dhe parime, si barazinë përpara ligjit, të drejtën e punës, atë të arsimit dhe parimin e sigurisë juridike.

- 8.1.2. *Së drejtës së ankimit*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë pranuar ankim të veçantë ndaj aktit sanksionues me natyrë penale.
- 8.1.3. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi gjykata e apelit, duke arsyetuar se nuk është kompetente për gjykimin e ankimit ndaj gjobës, sepse duhet ta gjykojë së bashku me vendimin përfundimtar të themelit të çështjes, konsiderohet një gjykatë e krijuar pa ligj.
- 8.1.4. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve e të kontradiktoritetit*, pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka gjykuar çështjen në themel, por *prima facie*, duke mos dëgjuar pretendimet përkundrejt fakteve, si dhe duke mos i referuar ato. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, nga ana e saj, nuk ka krijuar hapësirë ndaj së drejtës së ankimit, duke gjykuar një ankim pa iu referuar arsyetimit të vendimit të kundërshtuar.
- 8.1.5. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi gjykata e apelit nuk ka ballafaquar faktet me pretendimet, duke dhënë një vendim të paarsyetuar. Gjykata e Lartë, nga ana e saj, në arsyetimin e vendimit nuk ka referuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar asnjë prej shkaqeve të rekursit.
- 8.2. *Parimi i mosdënimit pa ligj*, i parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës, pasi disponimi ndëshkues me natyrë penale është bërë pa ligj, duke cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor, të drejtën e një gjykimi të drejtë publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.
- 8.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë vendosur një disponim të padëgjuar në jurisprudencën gjyqësore, duke ndëshkuar pa ligj përfaqësuesin e kallëzuesit.
- 8.4. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykatat kanë krijuar në invers “norma juridike të reja” për marrëdhëniet palë/përfaqësues, duke cenuar të drejtën e përfaqësuesit me prokurë për të mbrojtur, nëpërmjet institutit të përfaqësimit, palën në procesin gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor

që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, lidhur me ankimimin e disponimit të gjykatës për ndëshkimin me gjobë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Në kushtet kur kontrolli kushtetues ka një funksion subsidiar, ai mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit. Cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtijshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Megjithatë, në kuptim të përmbajtjes së nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, në jurisprudencën e saj Gjykata, në mënyrë përjashtimore, ka pranuar se objekt i gjykimit kushtetues mund të jenë edhe vendimet e ndërmjetme, të cilat edhe pse nuk vendosin për themelin e çështjes, gjithsesi plotësojnë këto kriteret: (i) vendimi i ndërmjetëm duhet që të ketë vendosur për të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, pra që shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; (ii) vendimi i ndërmjetëm duhet të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi

përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet; nr. 22, datë 04.04.2024; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke mbajtur parasysh për sa më sipër, në rastin konkret, edhe pse kërkuesi nuk është palë ndërgjyqëse e procesit të themelit, masa e gjobës ndaj tij është vendosur nga gjykata e shkallës së parë, në cilësinë e përfaqësuesit, dhe jo ndaj të mbrojturës prej tij. Prandaj, në drejtim të përmbushjes së kriterit të parë, Kolegji vlerëson se vendimi i kundërshtuar ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta ndaj kërkuesit. Gjithashtu, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, i cili së bashku me mospranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit ka vendosur edhe masën e gjobës ndaj kërkuesit, është ankimuar nga ai dhe më tej kundër vendimit të asaj gjykate është ushtruar edhe rekurs në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se përmbushet edhe kriteri i dytë, ai i shqyrtimit të pretendimeve të kërkuesit edhe nga gjykatat më të larta, të cilat janë shprehur për to.

14. Për sa i takon kriterit të tretë, e drejta e ankimit ndaj vendimit të ndërmjetëm, ashtu si dhe e drejta e ankimit të vendimit përfundimtar, u njihet vetëm palëve në proces (palëve ndërgjyqëse), pavarësisht nëse ato veprojnë personalisht ose përmes mbrojtësit të zgjedhur. Në këtë situatë, në kushtet kur kërkuesi nuk është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi i ndërmjetëm, ai nuk ka asnjë mundësi që të ankimojë vendimin përfundimtar dhe bashkë me të edhe vendimin e gjobës. Kjo do të thotë se ankimi i tij në përfundim të procesit gjyqësor është çështje që do të mbetet në vullnetin e të pandehurës së mbrojtur prej tij. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se nuk ka ndonjë garanci që procesi i themelit të mund të riparojë pasojat e vendimit të ndërmjetëm.

15. Nisur nga sa më lart, për sa kohë që vendimi i kundërshtuar ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta ndaj kërkuesit, është kundërshtuar në shkallët më të larta dhe ka një masë autonomie nga procesi i themelit, përjashtimi i tij nga kontrolli kushtetues do të sillte mohim të së drejtës për ankim kushtetues substancial. Për sa u takon pretendimeve të tij, Kolegji evidenton se kërkuesi i ka ngritur ato në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ai nuk ka mjet tjetër juridik efektiv në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka

të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 24.04.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 14.07.2025 (*sipas shërbimit postar*). Për sa më sipër, ankimi kushtetues individual i kërkuesit është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, për pasojë ai legjitimohet *ratione temporis*.

18. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nga pretendimet e kërkuesit, Kolegji evidenton se, në thelb, ato kanë të bëjnë me disponimin e vendimit që ka vendosur ndaj tij dënimin me gjobë në masën 50,000 lekë, në cilësinë e përfaqësuesit të palës në gjykim, disponim i cili është ngushtësisht i lidhur me disponimin parësor, atë të mospranimi të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit. Kërkuesi i ka lidhur pretendimet e tij me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar gjithashtu se këto vendime i kanë mohuar edhe disa të drejta të tjera, si parimin e barazisë përpara ligjit, të drejtën e punës, atë të arsimit, si dhe parimin e sigurisë juridike.

20. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) kur ka shqyrtuar raste të kësaj natyre ka analizuar zbatueshmërinë e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së për sa i përket aspektit civil ose penal. Sipas GJEDNJ-së, vendosja e gjobave për abuzimin e së drejtës për të paraqitur kërkesë është një masë procedurale që gjykata mund të marrë gjatë procesit që zhvillohet përpara saj, por ajo nuk përfshin një ndalim të përgjithshëm për përfaqësimin e klientëve përpara gjykatave të tjera. Vendosja e gjobave nuk mund të konsiderohet se përcakton të drejtën civile të kërkuesit për të ushtruar profesionin e avokatit. Për sa i përket reputacionit, GJEDNJ-ja ka konstatuar se në raste të tilla procesi gjyqësor nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me reputacionin profesional të avokatit, por me çështjen nëse ka abuzim me të drejtën e paraqitjes së kërkesës

nga ai në gjykatë. Prandaj, çështja e reputacionit është një nga pasojat e mundshme të konstatimit nëse ka pasur një abuzim të së drejtës së paraqitjes së kërkesës nga avokati. Për sa u përket gjobave të vendosura ndaj palëve në proceset gjyqësore për abuzim të procesit ose kundërshtim të gjyqtarit, ajo gjykatë ka vlerësuar se ato synojnë të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe, për rrjedhojë, kanë karakteristikat e sanksioneve procedurale që nuk përcaktojnë të drejta ose detyrime civile (*shih Žugić kundër Kroacisë, nr.3699/08, datë 31.05.2011, § 63*).

21. Lidhur me gjobat në fjalë, GJEDNJ-ja është shprehur se pasojat e pashmangshme monetare të tyre, shumat e të cilave nuk janë të larta, nuk janë në vetvete të mjaftueshme për zbatueshmërinë e aspektit civil të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së (*shih Adil Aktay kundër Turqisë, datë 09.01.2024, § 45*). Gjithashtu, po sipas GJEDNJ-së, parashikimet ligjore që u mundësojnë gjykatave të zakonshme të reagojnë ndaj sjelljeve jokorrekte të avokatëve në proceset gjyqësore kanë qëllimin që të sigurojnë funksionimin e duhur dhe të rregullt të këtyre proceseve (*shih Gestur Jónsson dhe Ragnar Halldór Hall kundër Islandës [DhM], datë 22.12.2020, §§ 81 dhe 89*).

22. Gjykata ka theksuar se dispozita procedurale që parashikon caktimin e gjobës si një mjet të ri për disiplinimin e procesit gjyqësor, ka për qëllim shmangien e abuzimeve me të drejtat në procesin gjyqësor dhe i kundërdrejtohet palës ose përfaqësuesit të saj, kur me vetëdije paraqet kërkesa ose pretendime abuzive. Dhënia e vendimit për caktimin e gjobës ndaj palëve ndërgjyqëse ose përfaqësuesve të tyre është një masë procedurale që i shërben funksionimit të duhur të procesit të rregullt gjyqësor dhe mirë administrimit të drejtësisë. Kjo do të thotë se gjoba e caktuar, në dallim nga gjoba administrative, ka regjim juridik të ndryshëm, pasi normohet nga një kuadër tjetër ligjor, jepet nga një organ gjyqësor dhe jo administrativ, si dhe ka për qëllim zhvillimin e procesit gjyqësor të themelit pa abuzim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimin nr. 22, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji evidenton se caktimi i gjobës ndaj kërkuarit ka qenë një masë procedurale që është vendosur në zbatim dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, e lidhur me ushtrimin e kompetencës së gjykatës për të siguruar zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor dhe konkretisht për të ndaluar abuzimin me ushtrimin e të drejtave gjatë procesit penal në të cilin kërkuari ka qenë në cilësinë e përfaqësuesit ligjor. Për më tepër, nuk është provuar nga kërkuari se masa e gjobës ka përcaktuar të drejta ose detyrime civile ndaj tij ose ka ndikuar në reputacionin e tij. Për rrjedhojë, bazuar në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe të argumenteve të paraqitura nga kërkuari, natyrën e gjobës, qëllimin për të cilin ajo është vendosur dhe kryesisht masën e saj, vlerësohet se ajo nuk prek ose ndërhyr në të drejtat kushtetuese të kërkuarit. Prandaj vendimi që ka caktuar gjobën ndaj kërkuarit nuk hyn

në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe pretendimet e tij nuk mund të merren në shqyrtim. Për rrjedhojë Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për kërkimet e tij.

24. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.